



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

77131,  
Nr. Prot

Tiranë, më 25/5/2021

URDHËR

Nr. 101, Datë 25/5/2021

“PËR MIRATIMIN E PËRKTHIMIT NË GJUHËN SHQIPE TË NDRYSHIMEVE NË  
STANDARDIN NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR 16 “QIRATË””

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, neni 12 Marrja e një vendimi jashtë mbledhjes,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 16 “Qiratë”.
2. Paragrafi C1C parashikon që një qiramarrës do të zbatojë ndryshimin në SNRF 16 për periudhat raportuese që fillojnë më 1 Prill 2021 e më pas. Zbatimi i mëparshëm është i lejuar, duke përfshirë edhe pasqyrat financiare të paautorizuara për t’u publikuar në 31 Mars 2021.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

